

## Detyrimi për të informuar banorët e afërm

Mbas një katastrofe të madh në vitin 1976 në një fabrik kimikal në Itali u mprehën ligjet në EU për trajtimin e lëndëve të rezikshme dhe ajo quhet Seveso direktivi II. Në Suedi u aplikua direktivi prej vitit 1999 me anë të ligjit dhe përmes dispozitës për masa për të parandaluar dhe kufizuar pasojat të një aksidenti serioz kimik. Stadexi përfshihet nga kërkesa më e lartë të këti direktivi, që do të thot se institutionet në Malmö janë të detyruar të informojne banorët në lagjen për rezicet që ekzistojn dhe se si ato duhet vepruar në rast të një aksidenti.

### giftfri stad

nätverket för en giftfri stadsmiljö

**Kush jemi ne?**  
Rrjeti për një qytet me ambient pa helm filloj në vjeshtë të vitit 2009 nga banorët, shoqata dhe aktorë të tjerë në rethinën e Norra Grängesbergsgatan në Malmö, kur ishte e qartë se çfarë reziku përmbante ndërmarja Stadex për ne në rethinën e afërm. Qëllimi jon është të informojmë banorët e afërm dhe popullin për ato rrezice që janë të lidhur me këtë lloj veprimtarie në një ambient qyteti të dendur.

- Ne duam që autoritetet përkatëse të rishqyrtojnë lejen e tyre ambiente dhe për dorimin e tyre të propylenoksidit!
- Ne duam që autoritetet përkatëse të shikojnë sipër planit të qytetit dhe lagjes tonë!
- Ne duam që Stadexi të na garantojë që ne nuk rizikojmë të prekemi nga kanceri apo dëme helmuese në riprodhim, para se tu lejohet të vazhdojnë me veprimtarinë!
- Neve parashtrijm kërkesën që qyteti i Malmö/ Shërbimi i shpëtimit/ Administrata e Prefekturës të marrë përgjegjësinë e vet dhe vendosë jetën dhe shëndetin e njeriut para fitimit të ndërmarjeve toksike private!

**Vepra tani!**  
Mer pjes dhe ti në rrjet, nënshkruaj nën mbledhjen e emrave dhe lexo më shumë për veprimtarinë helmuese të Stadexit në faqen tonë: [www.giftfristad.nu](http://www.giftfristad.nu)

Kontakt: [info@giftfristad.nu](mailto:info@giftfristad.nu) 0730 43 92 38

# KUJDES

# GAZ

# HELMUES



## Stadex

Kopparbergsgatan është ruga në zonën industriale të Sofielundit aty ku gjindet Stadex, një fabrik që prodhon amidon (koll, nisheste) për industrinë ushqimore me ndihmë të një lënde vdekjepruse që quhet Propylenoxid. Stadex ka përafërsisht 70 punonjës dhe një qarkullim të të ardhurave prej 215 milionë koronash. Fabrika filloj punën në vitin 1959 ku zona reth. Kopparbergsgatan dhe Norra Grängesbergsgatan ishte një zonë industriale vendosur në periferi të Malmö. Prej asaj kohës qyteti është ritur dhe Rosengården si dhe lagje të tjera janë ritur reth Stadexit. Poashtu dhe shkollat komunale si Annelundsskolan dhe Värner Rydenskolan janë tani të vendosura vetëm ca hapa larg fabrikës. Kommuna e Malmö shpreh që nuk ka ditur gjë për rezikshmerinë që përmban prodhimi e kesaj fabrike dhe ashkush nuk është ankuar për atë, ashtu që nuk është ndonjë shqetësim për rethinën. Në të njëjtën kohë shitore apo lokale shoqatash nuk lejohen në atë zonë dhe institutionet shtetërore në mënyrë konsekvante dëbojnë këto veprimtari. Si përshembull, famullia Myslimane si dhe stacioni i plehrave (Sopstationen) janë larguar nga lokalet veta në atë lagje.

Pyetjet janë:

*Si mund të jetë e lejuar që një fabrik të vendoset pa u informuar fillimisht për reziqet?*

*Pse nuk janë rishqyrtuar vendimet pasi kanë mësuar për ato rrezike?*

*A është realisht e arsyeshme që një fabrikë e atillë të mes të një lagjeje banimi?*

*Cilave interesa komuna ju jep përparsi, kur shoqata dhe shitore të vogla dëbonen, kurse Stadexit i lejohet të krye veprimtari të rezikshme për jetën e njerëzve në mes të një qyteti?*

## Propylenoxid

Propyleneksid është një lëndë që është vërtetuar të shkaktojë kancerin dhe ndryshimin e gjenetikës. Kjo lëndë është e rezikshme në vecanti për gra shtatzanë dhe fëmijë. Inspektori kikum thotë se theoretikisht një ekspozim i vetëm, me një dozë shumë të vogël mund të shkaktojë dëme të përhershme që në afat të gjat mund të shkaktojë kancer. Në këtë lagje Stadexi ka të drejtë të depozitojë deri në 53 ton të kësaj lëndë, që është shumë hemuese dhe një gaz e rezikshme për ndezje zjarri. Përveç asaj lëndë permban një rezik të madh eksplosioni (shpërthimi).



## Objektivi ambientor ne Suedi

Shteti i Suedisë ka pranuar qëllime ambiente kombëtare, mes të tjerave për një ambient pa helm. Aty ka një pjesë të qëllimit që vlen për përjashtimin e lëndëve të rezikshme, si për shembull lëndë që shkaktojnë kancerin si propylenoksid nuk do të përdoren më në procese prodhimi mbas viti 2010, vetëm nëse ndërmarjet mund të vërtetojnë se shëndeti dhe ambienti nuk do të pësojnë dëm. Kjo do të thotë që lëndë do të zëvendësohen me lëndë tjera me rezik më të vogël.

*A ka Stadexi ndonjë plan për të zëvendësuar propylenoksidin me ndonjë lëndë tjetër të pa rezikshme?*

*A kanë institucionet të përgjegjshme ndonjë plan për të detyruar Stadexin të zëvendësojë propylenoksidin me ndonjë lëndë tjetër të parerizikshme?*

*Dhe deri sa të ndodhe kjo – a mund të garantojë Stadexi që banorët dhe aktorët të tjerë në këtë lagje të mos ekspozohen për rezikun e zhvillimit të kancerit apo ndonjë dëm tjetër të përhershëm?*

## 33 vjet pa leje ambientor


Nuk ishte para vitit 1992 që shqyrtimi i parë të lejes së Stadexit u bë sipas ligjit për ruajtjen e ambientit dhe që u miratua. Stadexi ka të drejtë prej vitit 1998 të leshojë propylenoksidin në ujë dhe në ajër në rrethinën tonë. Tek shqyrtimi i lejes VA-verket ka qënë shumë kritik ndaj hulumtimeve që ndërmarja ka bërë dhe përpjekjeve të tyre për të zvogëluar hedhjet në ujë. Mbas 9 vjetësh përpjekjeve (1992-2001) VA-verket komentojnë që sasit nuk ishin të pranueshme dhe që zhvillimi shkante në anën e kundërt se ajo që ishte e dëshiruar. Gjatë vitit 2008 u përdorën totalisht 944 ton propylenoksid në prodhim.

## Cfarë ndodh në rast të një aksidenti?

Ndo se ndodh një aksident me propylenoksidin ka dy reziqe për banorët dhe për ato që gjenden në afërsi të Stadexit:

**Eksplozion re gazi.** Tek një eksplozion e një reje gazi mund të shkaktojë dëme në ndërtesa dhe nerëz në gjithë lagjen ku gjemdet Stadexi dhe dëme në dritare deri në 300 metra prej fabrikës.

**Re gazi helmues.** Nëse një re gazi helmues shpërndahet, helmet mund të mbërin deri në 1400 metra prej Stadexit. Mbrenda 200 metrave prej vendit të aksidentit mund të ketë rezik direkte për jetën e njeriut.



## Incidente

Deri tani janë dokumentuar disa incidente të shkaktuara nga Stadexi. Shembuj prej viteve të fundit janë:

- Eksplosion në një gyp dhe propylenoksidin u derdh në ambient (2001)
- Një zjarri i ndezur në depo (magazinë) dhe alarmi i zjarrit nuk punonte (2003)
- Zjarr në kablo të një karroceje klienti (2004)
- Derdhje në kanalizimin e ujrave (2008)
- Hedhje pluhuri që është vërejtur nga koqshiti (2008, 2009)

Kjo do të thotë reziqe serioze për shëndetin dhe sigurinë në rrethinën e afërm!